VENDIM
Nr. 24, datë 21.4.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo Anëtar i " "
Sokol Berberi Anëtar i " "
Fatmir Hoxha Anëtar i " "
Gani Dizdari Anëtar i " "
Besnik Imeraj Anëtar i " "
Fatos Lulo Anëtar i " "

me sekretare Blerina Basha, në datën 19.11.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 39/12 Akti, që i përket:

KËRKUES: Rahime Goma, përfaqësuar nga z. Bardhyl Ibra me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Zyra Përmbarimore Elbasan, përfaqësuar nga z. Njazi Çoku me autorizim.

Gazmir Alla, në mungesë.

Ministria e Drejtësisë, në mungesë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit nr. 148, datë 16.5.2001 të ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, të ndryshuar me vendimin nr. 2594, datë 7.11.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si dhe me vendimin nr. 1197, datë 25.5.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Detyrimi i Zyrës së Përmbarimit Elbasan për zbatimin e menjëhershëm të vendimit, si dhe shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror në sasinë e vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese me anë të ekspertëve kontabël.

BAZA LIGJORE: Neni 131/f, 134/g, 42/2, 44 e 142/3 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6 i KEDNJ-së.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatos Lulo, përfaqësuesin e kërkueses që kërkoi pranimin e kërkesës, subjektin e interesuar Zyra Përmbarimore Elbasan, që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. ***Kërkuesja***, Rahime Goma, ka qenë e lidhur në martesë ligjore me subjektin e interesuar shtetasin Gazmir Alla, martesë e lidhur në datë 15.4.1998. Me vendimin gjyqësor nr. 148, datë 16.5.2001, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Librazhd ka vendosur për zgjidhjen e martesës dhe ushtrimin e përgjegjësisë prindërore për dy fëmijët e mitur (A.A. lindur më 24.5.1998 dhe M.A. lindur më 30.5.2000). Në zbatim të dispozitave përkatëse të Kodit të Familjes, në vendimin gjyqësor është vendosur dhënia e detyrimit për ushqim nga shtetasi Gazmir Alla për fëmijët e tij, sipas masës së përcaktuar nga gjykata. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Librazhd, me vendimin nr. 125, datën 28.9.2001, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të këtij vendimi.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 2594, datë 7.11.2008, ka vendosur ndryshimin e vendimit civil nr. 148, datë 16.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, për masën e detyrimit ushqimor për fëmijët A.A. dhe M.A., përkatësisht në vlerën 4.500 dhe 3.500 lekë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 38, datë 25.3.2009, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për këtë vendim.

3. Në vijim, po e njëjta gjykatë, me vendimin nr. 1197, datë 25.5.2011, ka ndryshuar sërish masën e detyrimit ushqimor për fëmijët A.A. dhe M.A., duke e caktuar atë në vlerën 6.000 dhe 5.000 lekë.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin penal nr. 263, datë 10.5.2012, ka deklaruar fajtor shtetasin Gazmir Alla, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 125 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim.

II

5. ***Kërkuesja***, Rahime Goma, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor, si dhe shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror nga ana e Zyrës Përmbarimore Elbasan, duke pretenduar se:

5.1 Çështja është administruar në mënyrë joefikase nga ana e Zyrës Përmbarimore Elbasan, pasi kjo zyrë duhet të kishte kërkuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për sa kohë debitori jeton në shtetin grek.

5.2. Zyra Përmbarimore Elbasan nuk ka ndjekur dhe zbatuar procedurat e parashikuara nga ligji nr. 9554, datë 8.6.2006 "Për ratifikimin e Konventën së Hagës "Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare", për dërgimin e dokumentacionit pranë autoriteteve të drejtësisë greke.

6. **Subjekti i interesuar**, Zyra Përmbarimore Elbasan, prapësoi pretendimet e kërkueses me argumentin se përmbaruesi gjyqësor i çështjes ka kryer të gjitha veprimet procedurale për gjetjen e pasurive të subjektit të interesuar, por ka rezultuar se ai nuk ka pasur pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në emër të tij.

7. Gjithashtu, Zyra Përmbarimore Elbasan, mbështeti prapësimet e saj në faktin se veprimet përmbarimore kanë qenë në vijimësi dhe pa ndërprerje. Në mungesë të hapësirave ligjore për ndjekjen e procedurave të ekzekutimit jashtë shtetit, kjo zyrë ka orientuar kërkuesen të nisë procedurat penale ndaj ish-bashkëshortit të saj për mospërmbushje të detyrimit të tij ndaj fëmijëve.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me legjitimimin e kërkueses

8. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se çështja e legjitimimit të kërkuesit lidhet drejtpërdrejt me inicimin e një procesi kushtetues. Individi, në kuptim të neneve 131, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "g" dhe pika 2 të Kushtetutës, mund të vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë

cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 31.3.2006; nr. 27, datë 20.6.2007; nr. 1, datë 19.1.2009*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet të vërë në lëvizje këtë gjykim kushtetues.

9. Gjykata ka vlerësuar faktin se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 31.3.2006; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 35, datë 27.10.2010*). Referuar çështjes objekt shqyrtimi, Gjykata vlerëson se ekzekutimi i vendimit nr. 148, datë 16.5.2001 të ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, të ndryshuar, me vendimet nr. 2594, datë 7.11.2008 dhe nr. 1197, datë 25.5.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, brenda një afati të arsyeshëm, është element i procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së dhe, për rrjedhojë, çështja objekt shqyrtimi përfshihet në rrethin e çështjeve të juridiksionit kushtetues.

B. Lidhur me pretendimin e kërkueses për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm

10. Gjykata ka vlerësuar se ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, por detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës është konsideruar si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësish, sepse vetëm pas realizimit të saj mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 43, datë 19.12.2007; nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 6, datë 4.3.2010*).

11. Gjykata rithekson se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet sipas rrethanave të çështjes, ku përfshihet kompleksiteti i çështjes, sjellja e kërkuesit dhe ajo e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr .1, datë 19.1.2009; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 14, datë 15.4.2010*).

i) Lidhur me kompleksitetin e çështjes

12. Gjykata ka ritheksuar vazhdimisht se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 14, datë 15.4.2010*).

13. Gjykata vëren se çështja konkrete ka të bëjë me ekzekutimin e një vendimi gjyqësor jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, procedurë e cila i nënshtrohet në mënyrë komplementare dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile dhe së drejtës ndërkombëtare të zbatueshme në marrëdhëniet dypalëshe me shtetin grek. Pavarësisht se në këtë rast ekziston baza ligjore e veçantë e zbatueshme (*Konventat e Hagës për detyrimet ushqimore, si dhe Konventa e vitit 1993 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë për ndihmë gjyqësore në çështjet civile dhe penale, e ratifikuar me ligjin nr. 7760, datë 14.10.1993*), Gjykata çmon se çështja paraqitet komplekse, pasi vënia në lëvizje e mekanizmave shtetërorë dhe transmetimi i kërkesave për ekzekutimin e një vendimi në fushën civile, familjare etj., jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ndikon në kohëzgjatjen e ekzekutimit të vendimit.

ii) Lidhur me interesin dhe sjelljen e kërkueses

14. Gjykata, në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes dhe i interesit të kërkuesit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke nënvizuar se përdorimi nga ana e kërkuesit të të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 14, datë 15.4.2010*).

15. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vlerëson se interesi i kërkueses është i dukshëm dhe real për sa kohë detyrimi ushqimor lidhet drejtpërdrejt me sigurimin e një standardi jetese të mjaftueshëm për zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe social të fëmijës.

16. Për periudhën 2001-2006, rezulton se kërkuesja ka paraqitur disa kërkesa pranë Zyrës Përmbarimore Elbasan, mbi bazën e të cilave janë kryer veprimet e nevojshme procedurale, të cilat kanë bërë të mundur që debitori të shlyejë detyrimin përkatës deri në muajin maj 2006. Kërkuesja, edhe pas marrjes së vendimeve nr. 2594, datë 7.11.2008 dhe nr. 2560, datë 25.5.2011 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka përmbushur detyrimet e saj procedurale si subjekt i gjykimit, duke arritur të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit për vendimet përkatëse, si dhe të depozitojë kërkesat pranë Zyrës Përmbarimore Elbasan për vënien e tyre në ekzekutim. Gjithashtu, kërkuesja i është drejtuar me kërkesë me shkrim Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë në kuadër të përgjegjësive të marra nga shteti shqiptar për shkak të ratifikimit të Konventës së Hagës "Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare".

17. Nga tërësia e fakteve dhe rrethanave të mësipërme, Gjykata vëren se kërkuesja ka përmbushur detyrimet e saj si subjekt procedural në komunikimet me Zyrën e Përmbarimit, porse referuar Konventës për ndihmë gjyqësore të vitit 1993 (*e sipërcituar si bazë ligjore e veçantë e zbatueshme në këtë rast*) rezulton se kërkuesja nuk ka shfrytëzuar mjetin juridik të ofruar nga kjo Konventë, me qëllim transmetimin e kërkesës së saj për njohje dhe ekzekutim vendimi në shtetin grek. Sipas kësaj Konvente, kërkesa lidhur me zbatimin e vendimit

duhet të depozitohet në Gjykatën Shkallës së Parë që ka dhënë vendimin, dhe më tej autoritetet gjyqësore të Palëve Kontraktuese do të komunikojnë midis tyre, për qëllimet e ndihmës juridike të ndërsjellë, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, me anë të organeve të tyre qendrore (d.m.th. nga ana e Republikës Greke me anë të Ministrisë së Drejtësisë dhe nga ana e Republikës së Shqipërisë me anë të Ministrisë së Drejtësisë). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se mosshterimi i mjetit të kërkimit për njohje dhe ekzekutim vendimi pranë autoriteteve gjyqësore përkatëse, nga ana e kërkueses, ka sjellë vonesa në përmbushjen e të drejtave të fituara në rrugë gjyqësore.

iii) Lidhur me sjelljen e autoriteteve përgjegjëse

18. Gjykata çmon se pikë kyçe në analizën e çështjes përbën edhe sjellja e autoriteteve kompetente shtetërore, nëse këto të fundit kanë marrë të gjitha masat e duhura në përmbushje të procedurës së ekzekutimit të një vendimi gjyqësor.

19. Gjykata ka thënë se në fazën e ekzekutimit të vendimeve marrin pjesë jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori nuk pranon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse, të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 4.3.2010*).

20. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se përmbaruesi gjyqësor, në cilësinë e subjektit procedural në fushën e ekzekutimit, ka kryer të gjitha veprimet procedurale për ekzekutimin e vendimeve, fakt i pretenduar nga kërkuesja se nuk është realizuar. Nga aktet e administruara gjatë gjykimit rezulton se në datën 28.9.2001, me njoftimin nr. 299, përmbaruesi gjyqësor i çështjes ka nisur procedurën për ekzekutimin vullnetar të detyrimit. Ky njoftim është kthyer nga shërbimi postar me shënimin se personi ndodhet në shtetin grek. Deri në fund të majit 2006, debitori ka shlyer detyrimin në periudha kohore të ndryshme sa herë është kthyer në territorin shqiptar. Në harkun kohor 2002-2006, sipas korrespodencës së Zyrës Përmbarimore Elbasan dhe autoriteteve të tjera shtetërore (sipas konfirmimit zyrtar të ZVRPP-së, Drejtoria Rajonale e Tatimeve, bankat e nivelit të dytë, Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor), është konfirmuar mungesa e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme për debitorin Gazmir Alla. Pas ndryshimit të masës së detyrimit ushqimor me vendim gjyqësor, me shkresat nr. 346 prot., datë 15.5.2009 dhe nr. 221 regj., datë 7.9.2011, ka vijuar procedura ligjore për ekzekutimin e vendimit, për shlyerjen e detyrimit për ushqim.

21. Nisur nga detyrimet që titulli IV i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë i njeh Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor, si dhe detyrat e përcaktuara në ligjin nr. 8730, datë 18.1.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor" për vënien në ekzekutim të një titulli ekzekutiv të njohur si të tillë nga juridiksioni gjyqësor shqiptar, Gjykata vëren se ky autoritet nuk ka tagrin ligjor të ndjekë procedurat e ekzekutimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se sjellja e Zyrës Përmbarimore Elbasan nuk ka ndikuar në mosvënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor.

22. Bazuar në faktet e parashtruara dhe në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata çmon se kërkuesja nuk i ka shteruar të gjitha mundësitë ligjore për përmbushjen e të drejtave të fituara me vendim gjyqësor dhe, për rrjedhojë, çështja objekt gjykimi nuk përbën cenim të procesit të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit brenda një kohe të arsyeshme.

23. Për shkak të rëndësisë së veçantë që paraqet çështja objekt gjykimi, Gjykata çmon të ndalet në evidentimin e rolit të Ministrisë së Drejtësisë, si autoritet qendror, në përmbushje të angazhimeve që shteti shqiptar ka ndërmarrë në kuadër të instrumenteve ndërkombëtare për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

24. Referuar bazës ligjore të zbatueshme në këtë çështje, Gjykata vëren se në kuadër të Konventës për ndihmë gjyqësore të vitit 1993 (*të sipërcituar*) dhe të konventave të Hagës për detyrimet ushqimore, Ministria e Drejtësisë është autoriteti qendror, i cili ngarkohet me detyra konkrete në kuadër të zbatimit të dispozitave të tyre. Në këtë kuptim, Gjykata evidenton faktin se ky organ, edhe pse nuk mund të investohej drejtpërdrejt nga kërkuesja në procesin e nisjes së një procedure për njohje dhe zbatim vendimi gjyqësor në territorin grek, nëpërmjet ekspertizës dhe praktikës që kjo ministri ndjek në zbatim të këtyre konventave, ka pasur të gjitha mundësitë për të orientuar drejt kërkuesen mbi bazën ligjore të përshtatshme, të zbatueshme në këtë rast, si dhe hapat që duhej të ndërmerrte për paraqitjen e kërkesës për njohje dhe ekzekutim vendimi në shtetin grek.

25. Detyrimi për të mbrojtur interesin e fëmijës është një parim thelbësor në sistemin juridik shqiptar dhe, në këtë kuptim, Gjykata nënvizon se institucionet shtetërore kanë detyrimin të trajtojnë me përparësi dhe shpejtësi çështjet, të cilat lidhen me interesat e fëmijëve. Në rastin konkret, veprimit institucional shtetëror i bashkëngjitet edhe detyrimi për të zbatuar në mënyrë efektive konventat ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, jo vetëm për shkak të statusit të së drejtës ndërkombëtare në rendin juridik vendas, por edhe për mbrojtjen e të drejtave në mënyrë konkrete dhe efektive.

C. Në lidhje me pretendimin për përllogaritjen dhe detyrimin e Zyrës Përmbarimore Elbasan të shpërblejë kërkuesen për dëmin pasuror dhe jo pasuror

26. Nisur nga praktika e mëparshme e Gjykatës për kërkime të njëjta (*shih vendimin nr. 31, datë 25.3.2011*), Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk legjitimohet në këtë kërkim, pasi nuk është në kompetencë të Gjykatës të shqyrtojë dhe të vlerësojë dëmin pasuror e jopasuror të shkaktuar për arsye që lidhen me moszbatimin e një vendimi gjyqësor. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se ky është një kërkim i ri, i cili mund të paraqitet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në bazë të dispozitave të Kodit Civil që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit të shkaktuar si rrjedhim i vonesës në pagimin e një shume parash (neni 450 i Kodit Civil). Vetëm pas ezaurimit të mbrojtjes juridiksionale, kërkuesi mund të vërë në lëvizje

procedurat kushtetuese, në bazë të nenit 131, shkronja "f", të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 8, datë 23.3.2010*).

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f", dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë pjesërisht kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

Nëpërmjet arsyetimit të saj, shumica ka arritur në përfundimin se kërkuesja nuk i ka shteruar të gjitha mundësitë ligjore për përmbushjen e të drejtave të fituara me vendim gjyqësor e për rrjedhojë çështja, objekt gjykimi, nuk përbën cenim të procesit të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit brenda një kohe të arsyeshme (*prg. 22 i vendimit*). Ajo ka çmuar se mosshterimi i mjetit të kërkimit për njohje dhe ekzekutim vendimi pranë autoriteteve gjyqësore përkatëse, nga ana e kërkueses, ka sjellë vonesa në përmbushjen e të drejtave të fituara në rrugë gjyqësore (*prg. 17 i vendimit*).

Nuk pajtohemi me këtë përfundim të shumicës, pasi, në vlerësimin tonë, sjellja e kërkueses nuk është bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Vlerësimi i sjelljes dhe i interesit të kërkuesit, si dhe sjellja e autoriteteve shtetërore janë dy ndër elementet përcaktuese të kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve (*shih vendimet nr. 50, datë 22.11.2011 dhe nr. 14, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në çështjen konkrete, vërehet se kërkuesja ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për rivendosjen e të drejtës së cenuar. Gjykata është shprehur se "lidhur me *pretendimin për shkeljen e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, ajo shqyrton *nëse ka pasur mjete* të cilave pala kërkuese duhet t'u drejtohej. Në këtë drejtim, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, në kuptim të nenit 13 të Konventës, *mjetet* në dispozicion të një ndërgjyqësi *për të parashtruar një ankesë për zgjatjen e procesit* janë "efektive", në qoftë se ato "parandalojnë shkeljen e pretenduar apo pengojnë vazhdimin e saj, apo ofrojnë një riparim të përshtatshëm për çdo shkelje që tashmë ka ndodhur" (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

Nga tërësia e fakteve dhe e rrethanave konstatohet se kërkuesja ka ndjekur procedurat përmbarimore për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, i ka kërkuar asistencë Ministrisë së Drejtësisë, si dhe i është drejtuar gjykatave të juridiksionit penal. Në vështrim të kuadrit ligjor në fuqi kërkuesja nuk ka mjete të tjera ligjore efektive në dispozicion për rivendosjen e së drejtës së cenuar. Rrjedhimisht, në vlerësimin tonë, nuk rezulton që sjellja e kërkueses të jetë bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

Për sa i përket sjelljes së autoriteteve shtetërore, Gjykata, në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, ka theksuar se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëlloj (*shih vendimin nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 46, datë 25.7.2012; nr. 35, datë 27.10.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Nga rrethanat e çështjes në shqyrtim vërehet se debitori nuk i ka përmbushur detyrimet e tij që nga viti 2006. Sipas Konventës së Hagës "Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes" të datës 23.11.2007, të ratifikuar nga Kuvendi me ligjin 63/2012, "shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura, (...) për të siguruar rivendosjen e detyrimit të mbështetjes financiare për fëmijën nga prindi (...) në veçanti kur këta persona jetojnë në shtet të ndryshëm nga ai i fëmijës". Interesat më të mira të fëmijës kanë rëndësi parësore dhe çdo fëmijë ka të drejtën e një standardi të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe social (*Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve, 1989 dhe preambula e Konventës së Hagës, 2007, supra*). Pra, referuar detyrimeve të mësipërme, në funksion të mbrojtjes së interesit të fëmijës, i cili përbën edhe një interes publik, autoritetet shtetërore duhet të bashkëpunojnë me autoritetet shtetërore të huaja për të zgjidhur çështje që kanë të bëjnë me interesat e fëmijëve. Në këtë kuadër, roli i Ministrisë së Drejtësisë, si autoritet shtetëror kompetent që transmeton kërkesat për njohje dhe ekzekutim vendimi jashtë territorit shqiptar, është i rëndësishëm si për fillimin e procedurave përkatëse apo lehtësimin e tyre, ashtu edhe për marrjen e masave të duhura për ofrimin e ndihmës ligjore. Referuar rastit konkret, Ministria e Drejtësisë nuk duhej të mjaftohej vetëm me një kthim përgjigjeje, por duhej të ndërmerrte masat e nevojshme dhe të asistonte kërkuesen për zgjidhjen e çështjes së ekzekutimit të vendimit gjyqësor, duke pasur parasysh se bëhej fjalë për një interes publik, siç është interesi i fëmijëve. Gjithashtu edhe mbi bazën e "Konventës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale" (1993), të ratifikuar me ligjin nr. 7760, datë 14.10.1993, shtetasit shqiptarë mund të kërkojnë njohjen dhe zbatimin një vendimi gjyqësor në territorin grek dhe Ministria e Drejtësisë ka rolin e hallkës ndërmjetëse të komunikimit me autoritetet e huaja (nenet 3, 23 të Konventës).

Për sa më lart, ndryshe nga shumica, çmojmë se pretendimi i kërkueses për cenimin e procesit të rregullt ligjor, për shkak të mosekzekutimit të vendimit brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës,

është i bazuar ndaj kërkesa e saj duhej pranuar.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi

Ndreqje gabimi

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 210, datë 9.4.2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1015, datë 27.11.2013 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, objekte, që preken nga rehabilitimi mjedisor i vijës së mbrojtur bregdetare Ujë i Ftohtë-Tuneli, Bashkia Vlorë””, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 54, datë 21 prill 2014, fq. 2129, në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, numri rendor 8:

Ishte:

Nr.	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja	Çmimi mesatar l/m²	Vlera në lekë	Shënime
8	16/8+2-21	8602	43.28	57000	2466960	Konfirmuar nga ZVRPP-ja

Bëhet:

Nr.	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja	Çmimi mesatar l/m²	Vlera në lekë	Shënime
8	16/8+1-21	8602	43.28	57000	2466960	Konfirmuar nga ZVRPP-ja